



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:088838

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05941043

KF.nr.585/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me procesmbajtësen Arlinda Hyseni në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Euro-Bag” N.P. me seli në Graçanicë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 8,233.02€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Kushtrim Bytyqi avokat, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Xhafer Krasniqi, me datë 27.06.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Euro-Bag” N.P me seli në Graçanicë.
- II. ANULOHET Pjesërisht Aktvendimi me nr.01.3.2.2/4481 i datës 06.04.2022 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Euro-Bag” N.P me seli në Graçanicë, t’ia kthej shumën prej 8,233.02 €, (tetëmijë e dyqind e tridhjetë e tre euro e dy centë), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-3791/05.02.2022, R-3985/07.02.2022, R-3991/07.02.2022, R-4037/08.02.2022 dhe R-4066/08.02.2022, të proceduar ZBD Intereuropa, me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.02.2024 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. MBETËT NË FUQI Aktvendimi me nr.01.3.2.2/4481 i datës 06.04.2022 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe atë sa i përket deklaratave unike doganore tani më jo-kontestuese R-4050/08.02.2022 dhe R-6607/28.02.2022.
- V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Euro-Bag” N.P me seli në Graçanicë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/4481 të datës 06.04.2022 për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave, shkeljes së dispozitave të Udhëzimit Administrativ 99/11 dhe Udhëzimit Administrativ 11/2009, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së rregullave të procedurës administrative. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaroi: Mbesim në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkeljet ligjore të referuar në padi përkatësisht neni 33 të KDAK lidhur me nenin 123 të UA11/2009 pasi që paditësi DUD-ave kontestues i ka bashkangjitur dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit. E paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se mungojnë kontrata e shitblerjes por konsiderojmë se ky qëndrim juridik nuk ka mbështetje ligjore sepse ky dokument nuk përcaktohet obligative në dispozitat ligjore të theksuara më sipër e në anën tjetër paditësi ka prezantuar dokumente të mjaftueshme të cilat vërtetojnë çmimin e paguar në emër të mallrave të importuara. Konsiderojmë se e paditura ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike me rastin e krahasimit të çmimeve të mjeteve të importuara nga paditësi me ofertën e çmimeve nga interneti pasi që konsiderojmë se këto oferta nuk paraqesin çmim të transaksionit sepse mund të negociohen edhe më tutje nga palët duke i shtuar kësaj edhe faktin se kemi të bëjmë me mallra të përdorura dhe krahasimin vetëm në bazë të modelit dhe shënimeve të tjera nuk mund të jetë objektiv derisa nuk krahasohet edhe gjendja faktike e amortizimit të tyre. Gjykatës në këtë seancë i dorëzoi edhe DUD-at me të cilët janë shkarkuar nga depot doganore. DUD-at kontestues sipas aktvendimit të atakuar dhe atë DUD R-8037/07.04.2022, R-5293/09.03.2022, R-2579/06.02.2024, R-9487/24.03.2023, R-7735/04.04.2022, R-18119/18.07.2022 dhe R-12101/18.04.2023 prej të cilëve 5 janë me regjim IM4 dhe dy janë me regjim EX3. Po ashtu gjykatës i dorëzoi edhe dëshmitë e pagesave të detyrimeve doganore për 5 DUD-at IM4. Duke marrë për bazë këto prova e njoftoj gjykatën se tanimë DUD-at IM7 R-4050 dhe R-6607 nuk janë më kontestues në këtë lëndë ngase të njëjtit janë shkarkuar me DUD-at EX3 nr.12101 dhe 7735, pra të njëjtit janë eksportuar derisa për DUD-at e tjerë bëjë precezimin e kërkesëpadisë si në vijim, ashtu që kërkesa e paditësit për kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore për shkak të rivlerësimit është në shumë prej 8,233.02 euro e cila është llogaritur si diferencë në mes të DUD-ave MV1

dhe MV6, krahasimi në mes të rubrikës 47 dhe e njëjta kërkojmë ti kthehet paditësit së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8% nga data 06.02.2024 kur është bërë pagesa e fundit në emër të detyrimeve doganore të DUD-ave kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur deklaroi "E kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Pretendimet e paditësit të shprehura në padi si dhe gjatë kësaj seance janë të pa bazuara sepse nuk qëndron pretendimi i tij se e paditura nuk ka konstatuar saktë gjendjen faktike. Në shkresat e lëndës lehtë vërtetohet se me rastin e deklarimit të mallit e paditura ka ndërmarrë të gjitha veprimet dhe ka shikuar mallin dhe ka konstatuar se paditësi ka deklaruar vlera më të ulëta nga ajo që disponon e paditura si të dhënat e disponueshme, e siç ka qenë katalogu OETRETEG dhe LLOT nr.3 dhe SHWACKE ku është marrë mesatarja nga çmimi i katalogut dhe në këtë rast edhe është konstatuar se paditësi ka deklaruar edhe vlera më të ulëta se sa të dhënat që i disponon e paditura. Gjithashtu, pretendimi i paditësit se paditësi ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm është pretendim i pa bazuar sepse e paditura në bazë të kompetencës ligjore ka shikuar mallrat dhe dokumentacionet dhe ka konstatuar se në dokumentacion paditësit i mungon kontrata e shitblerjes dhe për këtë arsye edhe është refuzuar ankesa në procedurën ankimore. Sa i përket precezimit të kërkesëpadisë që e bëri paditësi gjatë kësaj seance duke larguar edhe dy DUD-at tjerë me arsyetim se malli është eksportuar jashtë Kosovës nuk mund të deklarohet, për saktësinë e kërkesëpadisë nuk mund të deklarohet ngase kërkon kalkulime të cilat nuk mund ti bëjë tani në seancë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 01.3.2.2/4481 i datës 06.04.2022, Përgjigja në padi e datës 17.10.2022, ankesa e ushtuar në Doganë e datës 03.03.2022, DUD-at IM7 nr.3791, 3985, 3991, 4037, 4050, 4066 dhe 6607 me MV1 dhe MV6, DUD-at EX3 12101, 7735, DUD-at IM4 8037, 18119, 9487, 2579, 5293, Faturat 2021-852, 2021-048, 2022047, 2022028, 2022026, 2022024, 2021-851, 2021-036, Pagesat bankare

ndërkombëtare të datës 23.12.2021, 01.03.2021, 24.01.2022, 24.01.2022, 24.01.2022, 23.12.2021, 22.02.2022, Deklarata EXA, Proceset mbi përcaktimet e vlerës së mallrave dhe Pagesat bankare të detyrimeve doganore të datës 06.02.2024, 10.03.2022, 07.04.2022, 24.03.2023, 18.07.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se këtu paditësi, përmes DUD-ave R-3791/05.02.2022, R-3985/07.02.2022, R-3991/07.02.2022, R-4037/08.02.2022, R-4050/08.02.2020, R-4066/08.02.2022, dhe R-6607/28.02.2022 të proceduar në ZBD Intereuropa, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L109, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e për të cilën ankesë e paditura me datë 06.04.2022 ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/4481, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 04.05.2022, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate. Dhe në fund nuk është kontestues as fakti se tanimë DUD-at IM7 R-4050/08.02.2020 dhe R-6607/28.02.2022 nuk janë më kontestues në këtë lëndë ngase të njëjtit janë shkarkuar me DUD-at EX3 nr.12101 dhe 7735, pra të njëjtit janë eksportuar.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore R-3791/05.02.2022, R-3985/07.02.2022, R-

3991/07.02.2022, R-4037/08.02.2022, R-4050/08.02.2020, R-4066/08.02.2022, dhe R-6607/28.02.2022 të ZBD Intereuropa, dhe i ka lënë në fuqi të njëjtit. Me arsyetim se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e (6) gjashtë të vlerësimit nenit 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme ku bazë për rivlerësim ka marr katalogun OE “Tretrek” LOT3 dhe Shwacke, ku është marrë mesatarja nga çmimi i katalogut gjithmonë duke marrë për bazë llojet e mallit. Andaj, duke marrë parasysh që subjekti ankimor ka deklaruar vlerë tejet të ulët në krahasim me vlerën reale të këtij malli kontestues, si dhe subjekti nuk ka poseduar dokumentacion të mjaftueshëm për aplikim të nenit 33 të KDA-së, si dhe në bazë të dhënave nga interneti të cilat pasqyrojnë vlerën reale të mallit lëndor kontestues janë marrë çmimet me karakteristika të ngjashëm me mallin kontestues. Tutje ka theksuar se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave dokumentet përcjellëse të mallit lëndor janë vlerësuar si prova të pa mjaftueshme pasi që në shkresar e lëndës mungon kontrata e shitblerjes e lidhur ndërmjet eksportuesit të mallit dhe importuesit lidhur me çmimin e mallit, kushtet e pagesës, kushtet e dërgesës etj. Dogana e Kosovës disponon me të dhëna tjera dhe se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të mallit lëndor kontestues, pra subjekti ka deklaruar vlerë tejet të ulët në raport me vlerën reale të mallit lëndor kontestues, andaj, në bazë të këtyre ndryshimeve, përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit, është përcaktuar edhe çmimi për mallin lëndor, dhe në këtë kuptim Dogana e Kosovës ka bërë vlerësimin e provave që ka prezantuar subjekti ankimor me provat që ka shërbyer për referencë të vlerësimit të mallit, andaj, në këtë kuptim Dogana e Kosovës nuk ka mundur të bëjë konstatim tjetër të gjendjes faktike nga gjendja dhe çmimi i përcaktuar nga Sektori i Pranimit Qendror. Po ashtu, ka theksuar se Dogana e Kosovës mbi bazën e dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave me qëllim të përcaktimit të drejtë të vlerës doganore për mallin “Automjete për Transport të Udhëtarëve mbi 9 ulëse dhe mjeteve speciale të punës”, ka filluar implementimin e aplikacionit “Tretrek”, i cili aplikacion do të përdoret për rastet kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33 dhe 34 të KDA-së, por sipas nenit 35 bazuar në të dhënat e disponueshme të marra nga aplikacioni të përshtatura mbi bazën e vitit të prodhimit të regjistrimit të parë/prodhimit, orëve të punës , kilometrave të kaluara, gjendjes faktike dhe

karakteristikave të tjera teknike. Prandaj, për këtë arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 dhe dispozitave të nenit 34 par.2 pika a), b) dhe c) të KDA-së, andaj, aktvendimi është sjellë në kuptim të nenit 35 të KDA-së, duke refuzuar kërkesën sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave R-3791/05.02.2022, R-3985/07.02.2022, R-3991/07.02.2022, R-4037/08.02.2022 dhe R-4066/08.02.2022, të ZBD Intereuropa, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 8233.02 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes pagesave bankare ndërkombëtare me status të aprovuar të datës 23.12.2021, 01.03.2021, 24.01.2022, 24.01.2022, 23.12.2021, e të cilat janë në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përshkrimit si në faturë.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga zhdoganimet e mëhershme, në bazë të të cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës sipas zhdoganimeve të mëhershme, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga*

blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”.*

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat e mallit lëndor dhe të cilat janë paguar përmes urdhërpagesave bankare ndërkombëtare të lartcekura me status të aprovuar, e të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të shumës dhe pagesës së bërë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi aktvendimin e kontestuar të paditurës dhe e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën prej 8,233.02 €, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-3791/05.02.2022, R-3985/07.02.2022, R-3991/07.02.2022, R-4037/08.02.2022 dhe R-4066/08.02.2022, të proceduar ZBD Intereuropa, me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.02.2024 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet “*Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme*” dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit*” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës ka marrë datën e fundit të dëshmisë bankare të pagesës së detyrimeve doganore e cila është 06.02.2024.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.585/2022, datë 27.06.2024

Procesmbajtëse
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.